

**MARRËVESHJE MIDIS
REPUBLIKËS ITALIANE
dhe
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
NË FUSHËN E SIGURIMEVE SHOQËRORE**


Hyrje

Republika e Italisë dhe Republika e Shqipërisë, të nxitura nga dëshira për të përmirësuar marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve në fushën e sigurimeve shoqërore, kanë rënë dakord për dispozitat e mëposhtme.

**PJESA I
Dispozita të përgjithshme**

**Neni 1
Përkufizime**

- (1) Për qëllimet e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje:
- a) termi "Italia" nënkupton Republikën e Italisë; termi "Shqipëria" nënkupton Republikën e Shqipërisë;
 - b) termi "legjislacion" nënkupton rregulloret aktuale ose të ardhshme të secilit shtet kontraktues që kanë si objekt skemat e sigurimeve shoqërore që tregohen në nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje;
 - c) termi "Autoritet Kompetent" nënkupton përsa i përket Italisë, Ministrinë e Punës dhe Politikave Sociale, dhe përsa i përket Shqipërisë, Ministria përgjegjëse për Sigurimet Shoqërore;
 - d) termi "Institucion kompetent" nënkupton Institucionin në të cilin është regjistruar subjekti i interesuar në momentin e kërkesës për përfitime ose Institucionin ndaj të cilit i interesuari ka të drejtë për përfitime ose që do t'i lindte kjo e drejtë nëse ai ose anëtarët e familjes së tij do të banonin në territorin e Shtetit Kontraktues në të cilin ndodhet ky Institucion;
 - e) termi "Organ ndërlidhës" nënkupton zyrat, të cilat do të ngarkohen nga Autoritetet kompetente për të komunikuar drejtpërdrejt midis tyre dhe për të vepruar si ndërmjetës me Institucionet kompetente të dy shteteve kontraktuese, me qëllimin e ofrimit të përfitimeve që parashikohen në këtë Marrëveshje;
 - f) termi "punonjës" nënkupton personat që kryejnë veprimtari pune dhe që janë të siguar ose të pranuar në përfitimet e legjislacioneve të përmendura në nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje;
 - g) termi "anëtarë të familjes" nënkupton ata që përcaktohen ose njihen si të tillë nga legjislacioni në fuqi;
 - h) termi "të mbijetuar" nënkupton ata që përcaktohen ose njihen si të tillë nga legjislacioni në fuqi;
 - i) termi "qëndrim" nënkupton qëndrimin për një kohëzgjatje të shkurtër;
 - l) termi "vendbanim" nënkupton vendbanimin e zakonshëm;
 - m) termi "periudha sigurimi" nënkupton periudhat e kontributit dhe/ose të punësimit, të cilat janë përcaktuar ose janë marrë parasysh si periudha sigurimi nga legjislacioni në fuqi në lidhje me to;
 - n) termi "periudha ekuivalente" nënkupton periudhat e asimiluara në periudhat e sigurimit nga legjislacioni i zbatueshëm në fuqi në lidhje me to;
 - o) termi "përfitime" nënkupton përfitimet në para të parashikuara nga legjislacioni i njëjës apo tjetrës Palë.



(2) Çdo shprehje apo term tjetër i përdorur në këtë Marrëveshje ka kuptimin që i jepet nga legjislacioni i zbatueshëm në fuqi në lidhje me të.

Neni 2

Fusha e zbatimit material

(1) Kjo Marrëveshje zbatohet për legjislacionet që lidhen me:

në Itali:

- a) sigurimin e përgjithshëm të detyrueshëm për pension invaliditeti, pleqërie dhe familjar të punonjësve të punësuar, trajtimin e posaçëm të punonjësve të vetëpunësuar (artizanë, tregtarë, fermerë) dhe trajtimin e ndarë të këtij sigurimi të përgjithshëm të detyrueshëm;
- b) sigurimin për përfitimin për sëmundjet, ku përfshihen edhe tuberkulozi dhe barrë lindja;
- c) sigurimin e papunësisë;
- d) skemat e posaçme zëvendësuese dhe të veçanta të sigurimit, të krijuara për kategori të caktuara punonjësish, mbasi ato u referohen shërbimeve ose rrisqeve që mbulohen nga legjislacionet e treguara në shkronjat e mëparshme.

Në Shqipëri:

- a) sigurimin për pleqërinë, invaliditetin dhe pensionin familjar (pasjetuesit);
 - b) sigurimin për përfitimin për sëmundjet dhe barrë lindjen;
 - c) sigurimin e papunësisë.
- (2) Kjo Marrëveshje do të zbatohet njëllor në rast se rregullore të mëpasme modifikojnë legjislacionet e përmendura në pikën 1.
- (3) Kjo Marrëveshje do të zbatohet, gjithashtu, edhe për ligjet e një Shteti kontraktues që do të zgjerojnë skemat ekzistuese për kategori të reja punonjësish ose që do të krijojnë skema të reja të sigurimeve shoqërore, me kusht që Qeveria e shtetit tjetër kontraktues të mos njoftojë kundërshtimin e saj ndaj Qeverisë së shtetit të parë brenda tre muajve nga data e komunikimit zyrtar të këtyre zgjerimeve.
- (4) Kjo Marrëveshje nuk zbatohet për ligjet e dy Shteteve Kontraktuese në lidhje me pensionet sociale dhe përfitimet e tjera jo kontributdhënëse të paguara nga fondet publike, si dhe për shtimin e trajtimit minimal, me përjashtim të dispozitave të nenit 16.
- (5) Dispozitat e parashikuara nga kjo Marrëveshje do të zbatohen në përputhje me legjislacionet përkatëse kombëtare dhe duke respektuar detyrimet ndërkombëtare dhe, përsa i përket Italisë, detyrimet që rrjedhin nga të qenët anëtare e Bashkimit Evropian.

Neni 3


Fusha e zbatimit personal

- (1) Kjo Marrëveshje zbatohet për personat që janë ose kanë qenë subjekt i legjislacionit të njërit ose të të dy shteteve kontraktuese, si edhe për anëtarët e familjes dhe pasjetuesit e tyre të mbetur.
- (2) Kjo Marrëveshje zbatohet edhe për refugjatët, në bazë të Konventës së 28 korrikut 1951 në lidhje me Statusin e Refugjatëve dhe Protokollin e saj të 31 janarit 1967, si edhe për personat pa shtetësi, në bazë të Konventës së 28 shtatorit 1954 në lidhje me statusin e personave pa shtetësi që banojnë në territorin e një shteti kontraktues, të cilët janë ose kanë qenë subjekt i legjislacionit të njërit ose të të dy shteteve kontraktuese, si edhe anëtarëve të familjes dhe pasjetuesit e tyre.

Neni 4

Trajtim i barabartë

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, personat ndaj të cilëve zbatohet kjo Marrëveshje do të gëzojnë të njëjtat përfitime dhe do t'u nënshtrohen të njëjtave detyrime, sipas legjislacionit të secilit shtet kontraktues, me të njëjtat kushte si qytetarët e atij shteti. Përsa i përket Italisë, do t'u sigurohet trajtim i barabartë edhe qytetarëve të Bashkimit Evropian.



PJESA II

Dispozitat për legjislacionin në fuqi

Neni 5

Dispozita të përgjithshme

Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në nenet e mëposhtme 6 dhe 7, punonjësit ndaj të cilëve zbatohen dispozitat e kësaj Marrëveshjeje i nënshtrohen legjislacionit të Shtetit kontraktues në të cilin ata zhvillojnë veprimtaritë e punës së tyre.

Neni 6

Dispozita të veçanta

Dispozitat e përcaktuara nga neni 5 kërkojnë përjashtimet e mëposhtme:

- 1) Një punonjës i punësuar në një ndërmarrjeje të krijuar në një nga shtetet kontraktuese, i cili është dërguar në territorin e shtetit tjetër, do të mbetet subjekt i legjislacionit të shtetit të parë, me kusht që punësimi i tij në shtetin tjetër të mos e kalojë periudhën prej 24 muajsh.
- 2) Një person që kryen zakonisht një veprimtari autonome në territorin e njërit prej dy shteteve kontraktuese dhe që shkon për të ushtruar një veprimtari të tillë në territorin e shtetit tjetër për një periudhë të kufizuar kohe, vazhdon të jetë i siguruar sipas legjislacionit të shtetit të parë, me kusht që qëndrimi i tij në shtetin tjetër të mos e kalojë periudhën prej 24 muajsh.
- 3) Personeli udhëtues i shoqërive të transportit ajror, rrugor ose hekurudhor, i nënshtrohet ekskluzivisht legjislacionit të shtetit në territorin e të cilit ndodhet selia e shoqërisë.
- 4) Anëtarët e ekuipazhit të një anijeje që mban flamurin e njërit prej shteteve kontraktuese i nënshtrohen legjislacionit të shtetit të cilit i përket flamuri. Punonjësit e punësuar për ngarkimin dhe shkarkimin, riparimin ose mbikëqyrjen e anijeve, ndërkohë që ndodhen në një port të shtetit tjetër kontraktues, i nënshtrohen legjislacionit të shtetit të cilit i përket ai port.
- 5) Agjentët diplomatikë dhe konsujt e karrierës, si edhe personeli administrativ dhe teknik që u përkasin misionëve diplomatike dhe konsullorë, të cilët në ushtrimin e funksioneve të tyre dërgohen në territorin e shtetit tjetër kontraktues, mbeten subjekt, së bashku me anëtarët e familjes së tyre, i legjislacionit të shtetit kontraktues të cilit i përket administrata nga e cila ata varen.
- 6) Punonjësit e punësuar nga një administratë publike dhe personeli i barazvlefshëm i njërit prej shteteve kontraktues, të cilët në ushtrimin e funksioneve të tyre, dërgohen në territorin e shtetit tjetër kontraktues, së bashku me anëtarët e familjes së tyre, mbeten subjekt i legjislacionit të shtetit kontraktues të cilit i përket administrata nga e cila ata varen.

Neni 7

Dispozita të veçanta për personelin tjetër përveç atij që u përket Përfaqësive diplomatike

Personeli i përfaqësive diplomatike dhe konsullorë, përveç atyre të përcaktuara në pikën "6" të nenit 6, si dhe personeli vendas në shërbimin privat të agjentëve diplomatikë dhe konsullorë, ose anëtarë të tjerë të këtyre misionëve diplomatike dhe zyrave konsullorë, mund të ushtrojnë opsionin për zbatimin e legjislacionit të shtetit dërgues, sipas dispozitave të Marrëveshjes Administrative të parashikuara nga neni 19, me kusht që ata të jenë shtetas të atij shteti.

Neni 8

Përjashtimet nga nenet 5 dhe 6

Autoritetet kompetente të dy shteteve kontraktuese ose institucionet e deleguara prej tyre mund të parashikojnë me marrëveshje të përbashkëta, përjashtime, pavarësisht nga dispozitat e neneve 5 dhe 6 të kësaj Marrëveshjeje, në interes të punonjësve.



Neni 9

Eksportueshmëria e përfitimeve në para

Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, punonjësit që kanë të drejtë për përfitime në para nga njëri shtet kontraktues, do t'i marrin ato mbi bazën e një trajtimi të barabartë me shtetasit e atij shteti në territorin e shtetit tjetër kontraktues ose të një shteti të tretë, në respektim të legjislacionit të secilit shtet.

Neni 10

Sigurimi vullnetar

(1) Për qëllimet e pranimit në sigurimin vullnetar, nëse parashikohet nga legjislacioni i njërit prej shteteve kontraktuese, periudhat e sigurimit të plotësuara sipas legjislacionit të atij shteti grumbullohen, nëse është e nevojshme, me periudhat e sigurimit të plotësuara sipas legjislacionit të shtetit tjetër kontraktues, me kusht që ato të mos mbivendosen dhe sipas dispozitave të parashikuara nga legjislacioni i secilit shtet.

(2) Regjistrimi i njëkohshëm në sigurimin e detyrueshëm të një shteti kontraktues dhe sigurimin vullnetar të shtetit tjetër lejohet vetëm në rast se një mundësi e tillë lejohet nga legjislacioni i këtij të fundit.

Neni 11

Bashkimi i periudhave

Për qëllimet e fitimit, ruajtjes ose rikuperimit të së drejtës për përfitime në para, të parashikuara nga kjo Marrëveshje, periudhat e sigurimit ose ato të barazvlefshme me to, të plotësuara sipas legjislacionit të njërit shtet kontraktues, bashkohen, nëse është e nevojshme, me periudhat e sigurimit ose ato të barazvlefshme me to, sipas ligjeve të shtetit tjetër kontraktues, me kusht që ato të mos mbivendosen.

PJESA III

Dispozita të veçanta

Kapitulli I

Pensionet

Neni 12

Pensionet që paguhen sipas legjislacionit të njërit shtet kontraktues (në regjim autonom)

Nëse një punonjës i plotëson kushtet e përcaktuara nga legjislacioni i njërit shtet kontraktues për të fituar të drejtën e përfitimeve pa pasur nevojë të përdorë bashkimin e periudhave të sigurimit, sikurse parashikohet në nenin 11, institucioni kompetent i atij shteti duhet të japë shumën e përfitimit të llogaritur ekskluzivisht në bazë të periudhave të sigurimit të plotësuara sipas legjislacionit që ai zbaton. Kjo dispozitë zbatohet edhe në rast se i siguruari ka të drejtë, nga shteti tjetër kontraktues, për një përfitim të llogaritur sipas nenit 13.

Neni 13

Pensionet e paguara sipas legjislacioneve të dy shteteve kontraktuese (bashkimi ndërkombëtar dhe proporcional)

(1) Nëse një punonjës nuk i plotëson kushtet e parashikuara nga legjislacioni i njërit shtet kontraktues për të drejtën për përfitime të bazuara vetëm në periudhat e sigurimit dhe shumën e barazvlefshme të plotësuara sipas atij legjislacioni, institucioni kompetent i atij shteti do të zbatojë dispozitat e përcaktuara nga neni 11.

(2) Nëse legjislacioni i një shteti kontraktues ia nënshton dhënien e përfitimeve kushtit që periudhat e sigurimit të jenë plotësuar në një profesion që i nënshtrohet një skeme të veçantë, për të përcaktuar të drejtën për përfitime të tilla bashkohen-vetëm periudhat e plotësuara në një skemë të



barazvlefshme në shtetin tjetër kontraktues ose, në rast se nuk ka, në të njëjtin profesion ose punë, edhe nëse në shtetin tjetër nuk ekziston një regjim i veçantë për atë profesion apo punë. Nëse shuma e përgjithshme e këtyre periudhave të sigurimit nuk lejon fitimin e së drejtës së përfitimeve sipas skemës së veçantë, këto periudha do të përdoren për të përcaktuar të drejtën për përfitime në skemën e përgjithshme.

(3) Për qëllimet e përcaktimit të përfitimeve të duhura në zbatim të dispozitave të nenit 11, institucioni kompetent i secilit shteti kontraktues do të veprojë si më poshtë:

- a) përcakton masën teorike të përfitimit për të cilën do të kishte të drejtë i interesuari, nëse të gjitha periudhat e bashkuara të sigurimit do të ishin plotësuar sipas legjislacionit të tij;
- b) përcakton pra shumën efektive të përfitimit për të cilin ka të drejtë i interesuari, duke e ulur shumën teorike të përmendur në pikën 1 të paragrafit 3, në bazë të raportit ndërmjet periudhave të sigurimit të plotësuar sipas legjislacionit që ai zbaton dhe periudhave të sigurimit të kryera në të dy shtetet kontraktuese;
- c) nëse kohëzgjatja e përgjithshme e periudhave të sigurimit të plotësuar sipas legjislacionit të të dy shteteve kontraktuese e tejkalon kohëzgjatjen maksimale të kërkuar nga legjislacioni i një shteti për t'u kualifikuar për një përfitim të plotë, institucioni kompetent do të marrë parasysh këtë kohëzgjatje maksimale, në vend të kohëzgjatja së përgjithshme të periudhave në fjalë;

(4) Nëse legjislacioni i një shteti kontraktues parashikon që përfitimet të llogariten në lidhje me shumën e pagave, të të ardhurave ose të kontributeve, institucioni kompetent i atij shteti do të marrë parasysh vetëm pagat ose të ardhurat e marra, ose kontributet e paguara, në përputhje me legjislacionin që ai zbaton.

Neni 14

Periudha sigurimi më pak se një vit

Pavarësisht nga sa parashikohet nga dispozitat e nenit 13, nëse kohëzgjatja e përgjithshme e periudhave të sigurimit të plotësuar sipas legjislacionit të një shteti kontraktues nuk arrin të paktën një vit dhe nëse, duke marrë parasysh vetëm këto periudha, nuk lind e drejta për përfitime sipas atij legjislacioni, institucioni i këtij shteti nuk është i detyruar të paguajë përfitime për këto periudha. Megjithatë, këto periudha sigurimi merren parasysh nga institucioni kompetent i shtetit tjetër kontraktues, si për qëllimin e fitimit të së drejtës për përfitime sipas legjislacionit të atij shteti, ashtu edhe për llogaritjen e tyre.

Neni 15

Pensionet në rast se personi nuk i plotëson njëkohësisht kushtet e përcaktuara nga ligjet e dy shteteve kontraktuese

Në qoftë se një punonjës, edhe duke marrë parasysh bashkimin e periudhave të sigurimit që përmendet në nenin 11, nuk plotëson në të njëjtën kohë kushtet e kërkuara nga ligjet e të dy shteteve kontraktuese, e drejta e tij e pensionit përcaktohet në lidhje me secilin legjislacion, pasi të plotësohen këto kushte.

Neni 16

Pensionet minimale

(1) Secili nga shtetet kontraktuese, nëse plotësohen kushtet e parashikuara nga legjislacioni i tij, do t'i shtojë trajtimin minimal përfitimet, e drejta e të cilave arrihet në bazë të nenit 11, vetëm nëse përfituesi banon në territorin e tij.

(2) Shtesa për trajtimin minimal të përmendur në paragrafin e mëparshëm është përgjegjësi e vetme e institucionit kompetent të shtetit kontraktues në territorin e të cilit banon përfituesi.



Neni 17**Dispozita të veçanta**

Nëse legjislacioni i njërit prej shteteve kontraktuese ia nënshton dhënien e përfitimeve kushtit që punonjësi t'i nënshtrohet këtij legjislacioni në momentin kur shfaqet rrishtu ky kusht konsiderohet i plotësuar nëse, me shfaqjen e rrishtit, punonjësi i nënshtrohet legjislacionit të një shteti tjetër kontraktues ose mund ta kërkojë të drejtën për përfitime në këtë të fundit.

Kapitulli II**Papunësia****Neni 18****E drejta për përfitime**

(1) Nëse një punonjës nuk i plotëson kushtet e përcaktuara nga legjislacioni i njërit shteti kontraktues për të drejtën e përfitimit të papunësisë duke u bazuar vetëm në periudhat e punës që u nënshtrohen kontributeve të plotësuara sipas atij legjislacioni, institucioni kompetent i atij shteti do të marrë parasysh, në masën e nevojshme, periudhat përkatëse të punës të kryera sipas legjislacionit të shtetit tjetër kontraktues.

(2) Zbatimi i dispozitave që përmban paragrafi i mëparshëm varet nga kushti që punonjësi t'i jetë nënshtuar së fundmi, për të paktën gjashtë muaj, legjislacionit sipas të cilit kërkohen përfitimet.

(3) Një punonjës që plotëson kushtet e përcaktuara nga legjislacioni i një Shteti Kontraktues për të drejtën e përfitimit të papunësisë dhe shkon në shtetin tjetër kontraktues për të kërkuar punë atje, e ruan të drejtën për përfitime të tilla sipas kushteve të përcaktuara nga legjislacioni i shtetit në të cilin është fituar e drejta, për një kohëzgjatje maksimale prej 3 muajsh, së cilës i zbritet periudha në të cilën ai i ka gëzuar tashmë përfitimet në atë shtet. Shërbimet do të vazhdojnë të ofrohen nga institucioni i shtetit kompetent në mënyrën e përcaktuar në Marrëveshjen administrative të përmendur në nenin 19.

PJESA IV**Dispozita të ndryshme****Neni 19****Marrëveshja administrative**

Autoritetet kompetente të dy shteteve kontraktuese do të bien dakord për legjislacionin zbatues të kësaj Marrëveshjeje me anën e një marrëveshjeje administrative që do të bëhet e vlefshme në të njëjtën kohë kur do të hyjë në fuqi kjo Marrëveshjeje.


Neni 20**Shkëmbimi i informacioneve**

Autoritetet kompetente të dy shteteve kontraktuese marrin përsipër të informojnë njëri-tjetrit në lidhje me:

- 1) të gjitha masat e marra për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje;
- 2) të gjitha vështirësitë që mund të shfaqen në nivel teknik për zbatimin e dispozitave të Marrëveshjes;
- 3) të gjitha ndryshimet në legjislacionet përkatëse që ndikojnë në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 21**Bashkëpunimi administrativ**

(1) Autoritetet, institucionet kompetente dhe organet ndërlidhëse të dy shteteve kontraktuese marrin përsipër t'i ofrojnë njëri-tjetrit ndihmë dhe bashkëpunim të ndërsjellë për zbatimin e kësaj



Marrëveshjeje. Ata mund të përdorin, gjithashtu, kur është e nevojshme, mjete hetimore në shtetin tjetër kontraktues, nëpërmjet autoriteteve diplomatike dhe konsullore të atij shteti.

(2) Autoritetet, institucionet kompetente dhe zyrat ndërlidhëse italiane që bashkëpunojnë për zbatimin e kësaj marrëveshjeje, e bëjnë këtë në kuadër të veprimtarisë së vetë institucionale, pa kosto të reja apo të shtuara për buxhetin publik, edhe duke iu referuar në mënyrë specifike detyrimeve të parashikuara në këtë titull.

(3) Një palë kontraktuese vë në dispozicion të palës tjetër kontraktuese falas dokumentacionin në lidhje me verifikimet dhe kontrollet mjekësore të kryera më parë që kanë të bëjnë me personat që banojnë ose qëndrojnë në territorin e shtetit tjetër kontraktues, për qëllime të kësaj marrëveshjeje. Verifikimet dhe kontrollet mjekësore që kryhen për zbatimin e legjislacionit të njërit shtet kontraktues dhe që kanë të bëjnë me personat që banojnë ose qëndrojnë në territorin e shtetit tjetër kontraktues, duhet të urdhërohen nga institucioni i vendqëndrimit ose i vendqëndrimit, me kërkesë të institucionit kompetent dhe me shpenzimet e tij. Në Marrëveshjen administrative të përcaktuar në nenin 19 do të përcaktohen dispozitat për rimbursimin e shpenzimeve. Shpenzimet për kontrollet shëndetësore dhe verifikimet e kryera në interes të institucioneve të të dy shteteve nuk japin të drejtën për rimbursim.

Neni 22

Ndihma diplomatike dhe konsullore

Autoritetet diplomatike dhe konsullore të secilit shtet kontraktues mund t'u drejtohen drejtpërdrejt autoriteteve, institucioneve kompetente dhe organeve ndërlidhëse të shtetit tjetër kontraktues për të marrë informacione të dobishme për mbrojtjen e qytetarëve të shtetit të tyre, të cilët ata i konsiderojnë si mbajtës të të drejtave mbi bazën e pranimit të Marrëveshjes në fjalë dhe mund t'i përfaqësojnë ata pa pasur një mandat të posaçëm.

Neni 23

Përfjashtimet dhe njohja e vërtetimeve

(1) Nëse legjislacioni i një shteti kontraktues, parashikon përfjashtimin nga taksat, vulat apostile apo tarifatat për kërkesa apo dokumenta të cilat duhen paraqitur sipas këtij legjislacioni, atëherë ky përfjashtim vlen edhe për kërkesa dhe dokumenta të cilat paraqiten apo lëshohen nga institucionet dhe autoritetet kompetente të shtetit tjetër kontraktues për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

(2) Të gjitha aktet, dokumentet dhe gjithçka tjetër e shkruar, të cilat duhet të paraqiten për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, janë të përfjashtuara nga viza e legalizimit nga autoritetet diplomatike dhe konsullore.

(3) Vërtetimi, i lëshuar nga autoritetet, institucionet kompetente dhe organet ndërlidhëse të njërit shtet kontraktues, në lidhje me vërtetësinë e një certifikate ose dokumenti, konsiderohet e vlefshme nga autoritetet përkatëse, institucionet dhe organet ndërlidhëse të shtetit tjetër kontraktues.

Neni 24

Organet e ndërlidhjes

Për të lehtësuar zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe për të lejuar një lidhje më të shpejtë ndërmjet institucioneve të të dy shteteve kontraktuese, autoritetet kompetente do të caktojnë organet ndërlidhëse.

Neni 25

Kërkesat, deklaratat dhe ankesat

(1) Kërkesat, deklaratat dhe ankesat që i paraqiten në kuadrin e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, një autoriteti, institucioni ose një organi ndërlidhës të njërit shtet kontraktues, konsiderohen si kërkesa, deklarata ose ankesa që i paraqiten autoritetit, institucionit përkatës ose organi ndërlidhës të shtetit tjetër kontraktues.

(2) Ankesat që duhet të depozitohen brenda një periudhe të caktuar pranë një autoriteti ose institucioni kompetent të njërit shtet kontraktues, konsiderohen të paraqitura brenda afatit nëse ato



janë i paraqitur brenda së njëjtës periudhë një autoriteti ose institucioni përkatës të shtetit tjetër kontraktues. Në këtë rast, Autoriteti ose institucioni të cilit i janë paraqitur ankesat, do t'ia përcjellë ato pa vonesë Autoritetit ose institucionit kompetent të shtetit tjetër kontraktues.

Neni 26

Letërkëmbimi ndërmjet Autoriteteve, Institucioneve dhe Organeve Ndërlidhëse

Autoritetet, institucionet kompetente dhe organet ndërlidhëse të dy shteteve kontraktuese, për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, mbajnë letërkëmbim të drejtpërdrejtë me njëra-tjetrën, me punonjësit dhe përfaqësuesit e tyre, duke e hartuar letërkëmbimin në gjuhët e tyre kombëtare përkatëse.

Neni 27

Pagesa e përfitimeve

(1) Pagesa e përfitimeve për përfituesit që banojnë në shtetin e Palës tjetër Kontraktuese duhet të kryhet në monedhën e Palës Kontraktuese që kryen pagesën dhe në përputhje me legjislacionin që ajo zbaton.

(2) Për qëllimet e zbatimit të paragrafit (1), kurset e referimit të këmbimit janë si më poshtë:

- për Italinë, ato të publikuara nga Banka e Italisë.
- për Shqipërinë, kursi ditor i këmbimit të bankës që kryen pagesën;

Neni 28

Rikuperimet

Institucioni i njërit shtet kontraktues i cili ka paguar një përfitim të paligjshëm ose një shumë që e tejkalon atë për të cilën përfituesi do të kishte të drejtë, mund t'i kërkojë institucionit kompetent të shtetit tjetër kontraktues të rikuperojë shumat e paguar në mënyrë të paligjshme për pagesat e prapambetura të pensioneve ose për ndonjë përfitim tjetër që i detyrohen përfituesit. Institucioni i shtetit kontraktues i ngarkuar për rikuperimin e kryen mbajtjen në burim sipas kushteve dhe brenda kufijve të parashikuara për këtë kompensim në përputhje me legjislacionin e zbatuar nga vetë ai. Shumat e mbajtura në burim i transferohen institucionit kreditor.

Neni 29

Mbrojtja e të dhënave personale

Çdo e dhënë që lidhet me individët që, për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, përcillet nga njëri shtet kontraktues në tjetrin, duhet të mbahet konfidenciale dhe të përdoret ekskluzivisht për të përcaktuar të drejtën për përfitime në bazë të kësaj Marrëveshjeje.

Të gjitha shkëmbimet e të dhënave ndërmjet Shteteve kontraktuese do të rregullohen nga dispozitat e përcaktuara në Aneksin 1 të kësaj Marrëveshjeje.

PJESA V

Dispozita kalimtare dhe përfundimtare

Neni 30


Data e hyrjes në fuqi

(1) Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje zbatohen për kërkesat për përfitime të paraqitura nga data e hyrjes së saj në fuqi.

(2) Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, do të merren parasysh edhe periudhat e sigurimit që janë plotësuar përpara hyrjes së saj në fuqi.

(3) Kjo Marrëveshje nuk jep të drejtën për përfitime për periudha përpara hyrjes së saj në fuqi.

(4) Një e drejtë për përfitime fitohet sipas kësaj Marrëveshjeje, edhe nëse ajo ka të bëjë me një ngjarje të mbuluar me sigurim, e cila ka ndodhur përpara datës së hyrjes së saj në fuqi.




Neni 31 Hyrja në fuqi


- (1) Kjo Marrëveshje do të ratifikohet nga të dyja shtetet kontraktuese, në përputhje me procedurat e tyre përkatëse dhe instrumentet e ratifikimit do të shkëmbehen sa më shpejt që të jetë e mundur.
- (2) Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi njëkohësisht me Marrëveshjen Administrative të përmendur në nenin 19, në ditën e parë të muajit të dytë pas shkëmbimit të dokumentave të ratifikimit.
- (3) Kjo Marrëveshje mund të denoncohet nga njëri shtet kontraktues dhe do të pushojë së qeni në fuqi gjashtë muaj pas njoftimit përkatës të saj nëpërmjet kanaleve diplomatike.
- (4) Në rast denoncimi të kësaj Marrëveshjeje:
 - a) të drejtat e fituara do të ruhen në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje;
 - b) të gjitha procedurat në vazhdim për njohjen e të drejtave do të përfundojnë në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje;
 - c) të drejtat që ndodhen në proces fitimi do të njihen sipas marrëveshjeve që do të lidhen ndërmjet dy shteteve kontraktuese.

Nënshkruar më 6/2/2024 në Romë, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën italiane dhe në gjuhën shqipe, të cilat janë të gjitha të barazvlefshme.

Për Qeverinë e Republikës së Italisë



Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë



ALLEGATO I

Clausole sul trasferimento di dati personali tra le Autorità competenti di cui all'art. 29 dell'Accordo tra la Repubblica italiana e la Repubblica di Albania in materia di sicurezza sociale

Considerati l'art. 46 (2) (a) del Regolamento (UE) 2016/679 del Parlamento europeo e del Consiglio del 27 aprile 2016 relativo alla protezione delle persone fisiche con riguardo al trattamento dei dati personali nonché alla libera circolazione di tali dati e che abroga la Direttiva 95/46/CE (Regolamento Generale sulla Protezione dei Dati/RGPD) e la legge dell'ordinamento albanese n° 9887 del 10/03/2008 in materia di protezione dei dati personali).

Ciascuna «Autorità competente» di una Parte (in seguito Autorità), di cui all'art. 1 lettera c dell'Accordo tra la Repubblica italiana e la Repubblica di Albania in materia di sicurezza sociale (in seguito Accordo), applicherà le garanzie specificate nelle Clausole del presente allegato per il trasferimento di dati personali ad un'Autorità dell'altra Parte. Tali garanzie sono vincolanti per le Parti e prevalgono su eventuali obblighi confliggenti esistenti nei rispettivi ordinamenti.

I. Definizioni

Ai fini delle presenti clausole s'intende per:

- (a) «dati personali»: qualsiasi informazione riguardante una persona fisica identificata o identificabile («Interessato») ai sensi dell'Accordo. Si considera identificabile la persona fisica che può essere identificata, direttamente o indirettamente, con particolare riferimento a un identificativo come un nome, un numero d'identificazione, dati relativi all'ubicazione, un identificativo in rete o a uno o più elementi caratteristici della sua identità fisica, fisiologica, genetica, psichica, economica, culturale o sociale.
- (b) «dati particolari»: dati personali che rivelano l'origine razziale o etnica, le opinioni politiche, le convinzioni religiose o filosofiche, l'appartenenza sindacale, dati genetici o biometrici intesi ad identificare in modo univoco una persona fisica, nonché dati relativi alla salute, alla vita sessuale o all'orientamento sessuale della persona.
- (c) «dati penali»: dati personali relativi a condanne penali e reati o connesse misure di sicurezza.
- (d) «dati comuni»: dati personali che non sono particolari oppure penali.

